



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:269719
Datë: 15.12.2023
Numri i dokumentit: 05072847

C-IV.-14-5578

Ankuesi:

Sh M nga Prishtina,
Përfaqëson nga B I avokat nga Prishtina.

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “Ingeniering”, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht** ankesa dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN129-0026 dt.13 maj 2014.
- II. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **Sh M** në emër të kompensimit për paga të papaguara t’i paguaj **shumën prej 1,305.00€**.dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore t’i paguaj shumën prej **130.00€**, kurse **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadsisë përtej shumës së aprovuara.

Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

OBLIGOHET e paditura që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **104.00€**.
- III. HUDHET** ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN129-0024 dt.15 maj 2014.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.19 qershor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një kërkesë kundër Vendimit nr. PRN129-0026 dt.13 maj 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për tri pagat e papaguara, në shumë prej **1,860.00€**, nga N.SH “Ingeniering” (në likuidim). Ankuesi ka pohuar se vendimi i AKP-së nuk ka bazë të vlefshme juridike pasi që Ligji për Punën e Bashkuar është shfuqizuar që d.m.th se kërkesa për paga nuk është parashkruar, dhe se ligji është i qartë dhe se i takon e drejta e kompensimit për paga. Ankesës i ka bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të atakuar, Librezën e punës, Vërtetim, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

I autorizuari me dt.21 prill 2020, në gjykatë ka paraqitur parashtrësë për rregullimin dhe plotësimin e padisë, me anë të së cilës e ka goditur vendimin e AL nr. PRN129-0024 dt.15 maj 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 34,720.00€ nga NSH “Ingeniering”. Së bashku me këtë ankesë ka bashkëngjitur: Llogaritja e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2006, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Vërtetim të lëshuar nga NSH “Ingeniering”, Kopjen e vendimit të AL nr.PRN139-0063 dt.15 maj 2014 dhe Aktvendimin e trashëgimisë.

Me dt.11 gusht 2023, e paditura parashtrroi mbrojtjen e saj në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Andaj, kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Parashtruesi nuk rezulton të ketë ndërmarrë ndonjë veprim ligjor pranë gjykatës në lidhje me pretendimin për kompensim në pagë brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit nga dt.14 janar 2009. Pa paragjykuar qëndrimin se pretendimet e ankuesit janë të parashkruara, thekson gjithashtu se ato nuk janë të bazuara në ligj dhe prova. Propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor

I.Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL PRN129-0026 dt.13 maj 2014.

II. HUDHET ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN129-0024 dt.15 maj 2014.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të

Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa dispozita e nenit 42 par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14 par.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”*. Neni 55 par.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *“I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjenden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjenden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuar në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për tri pagat e papaguara të kërkuara në këtë lëndë ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012

ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Ingeriering”. Në këtë çështje, kontestuese ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi e kundërshton një pretendim të tillë duke u bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga NSH-ja dhe njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Nga provat e parashtruara nga ankuesi, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune te NSH-ja deri me datën e marrjes së njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dt.14 janar 2009 si dhe vërtetimi i nënshkruar nga drejtori i cili e mban vulën e NSH-së. Këto dokumente dëshmojnë se ankuesit nuk i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës si dhe nuk i është parashkruar e drejta e tij për të kërkuar tri paga të pa paguara. Andaj, gjykata e pranon si provë relevante dhe të bazuara provat tjera të parashtruara nga ankuesi se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhet në vërtetimin e lëshuar nga NSH-ja.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar në tërësi, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL me dt.02 tetor 2013. Gjykata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të dt.14 janar 2009 dhe kësaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa në tërësi është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Gjykata vëren se njoftimi i dt.14 janar 2009, është pranuar i borxhit nga N.SH dhe se parashkrimi ndërpritet me çdo pranuar borxhi nga debitori. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësaj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të saj kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit dhe kësaj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e

DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168, AC-I-20-0183 etj).

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh tri pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në Llogaritjen e të ardhurave për muajin dhjetor 2006, ku ankuesi pagën e fundit e cila i ishte paguar ishte në shumë prej 435.00€. Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore erdhi në përfundim se ankuesit i takojnë 4 paga e që i bie (3 x 435.00€=1,305.00€).

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 130.00€ në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Pjesa e hudhjes

Hudhet si e pas afatshme ankesa e ushtruar kundër vendimit AL nr.PRN129-0024 dt.15 maj 2014.

Neni 37.7. i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, parasheh: “Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit.”

Dhoma e Posaçme pasi ka shqyrtuar me kujdes ankesën dhe dokumentacionin përcjellës ka gjetur se ankesa nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 28.2.2.6 dhe 70.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe/ose nenin 37.7 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Ankuesi nuk e ka dorëzuar ankesën në gjykatë brenda afatit prej 30 ditëve nga data kur ai ka pranuar vendimin e ankimuar. Sipas vendimit të ankimuar data e lëshimit të tij është 15 maj 2014. Ankuesi dorëzoi ankesën e tij kundër vendimit në fjalë me 21 prill 2020, që do të thotë pas gjashtë vite pas afatit.

Për këtë në pajtim me nenet 28.1, 28.2, 28.3 dhe 70.2 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme, Ankesa kundër Vendimit Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN129-0024 dt.15 maj 2014, për dëmshpërblim nga shkëputja e parakohshme e kontratës së punës hedhet poshtë si e papranueshme.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për ankesë me dt.26 korrik 2023.

E paditura është obliguar që ti paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00€, në bazë të rregullores së Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe atë shumën prej 104.00€ për ankesë, si dhe 30.00€ për taksë gjyqësore. Shuma prej 104.00€ për përgjigje në mbrojtje u refuzua si e pa bazuar, pasi ankuesi nuk e ka paraqitur të njëjtën.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala